



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.152/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.03.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Almedical” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-05004-01-24-2019 me objekt “Blerje Materiale Radiologjie për nevojat spitalore” për vitin 2019 në SU “Shefqet Ndroqi” Tiranë - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 40,600 lekë pa tvsh, Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër: 4,872,000 lekë (pa TVSH). zhvilluar në datë 04.02.2019 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.

Ankimues:

“Medfau” shpk
Rruga “Mihal Duri”, 17/5, Nd.33 Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë
Sauk, Tiranë.

Subjekt i Interesuar: “Al Medical” shpk
Rruga Konferenca e Pezes, Banesa Nr.1, ish Magazinat
e ESKUT, Tirane

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Public Health Sector

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.01.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-05004-01-24-2019 me objekt “Blerje Materiale Radiologjie për nevojat spitalore” për vitin 2019 në SU “Shefqet Ndroqi” Tiranë - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 40,600 lekë pa tvsh, Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër: 4,872,000 lekë (pa TVSH). zhvilluar në datë 04.02.2019 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.

II.2. Në datën 04.02.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 11.02.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultojnë si më poshtë vijon:

- Al Medical	3,479,400	I kualifikuar
- Medfau	4,860,000	I kualifikuar

II.4. Në datën 13.02.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Al Medical” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Në datën 11.02.2019 u njohëm me mesazhin elektronik për klasifikimin përfundimtar të ofertave ku njoftohemi se është kualifikuar në vendin e parë oferta e Al Medical. Vendimi i KVO për kualifikimin si ofertë të vlefshme të kompanisë Al Medical është në kundërshtim me aktet ligjore duke qënë të bindur se kjo kompani nuk i plotëson kriteret për kualifikim të vendosura nga AK në DST. Në bazë të LPP, dhe ligjin Nr.131/2012 neni 21 E drejta e Informimit pika 2.c si ofertues i suksesshëm ne kërkojmë nga AK të na vihet në dispozicion dokumentacioni i paraqitur nga ky operator Al Medical për këtë prcedurë prokurimi.

- Tek kriteret e vecanta të kualifikimit ju kërkoni: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi, për tregtimin e artikuljeve të ofruar. (të përkthyer dhe të noterizuar) . Kompania Medfau shpk ka paraqitur një mostër të kompanisë Carestream sipas kërkesës së AK dhe bashkë me këtë është paraqitur edhe autorizimi i kompanisë prodhuese Carestream. A ka paraqitur operatori ekonomik Almedical i kualifikuar nga KVO si një ofertues I cili plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga ky komision një autorizim të tillë nga prodhuesi???. Nëse po a mundet që në përgjigjen tuaj të na bashkëngjisni një kopje të këtij dokumenti. Bashkëngjitur këtij formulari ankese ju lutem gjeni edhe një shkresë nga kompania prodhuese Carestream (e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar) ku shprehet qartë se kompania Medfau shpk është e vetmja kompani e autorizuar nga kompania prodhuese carestream për tregëtimin e produkteve që kjo kompani prodhon. Kjo shkresë vë në dyshim vlerësimin që KVO ka bërë duke mos u bazuar tek kërkesat që vetë ky AK ka kërkuar. KVO duke pranuar një operator ekonomik pa autorizimin e prodhuesit në rradhë të parë ka shkelur një nga pikat e vlerësimit të ofertave duke bërë një njëanshmëri në vlerësim dhe në rradhë të dytë ka pranuar që të marrë produkte të pacertifikuara dhe të autorizuar nga prodhuesi.

- Kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik Al Medical shpk.

II.5. Në datën 18.02.2019 me shkresën nr. 315/13 prot operatori ekonomik ankimues është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 25.02.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 315/17 prot datë 05.03.2019 protokolluar me tonën me nr.293/2 datë 07.03.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Medfau” shpk mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Almedical” shpk, në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “Tek kriteret e vecanta të kualifikimit ju kërkoni: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi, për tregtimin e artikujve të ofruar. (të përkthyer dhe të noterizuar) . Kompania Medfau shpk ka paraqitur një mostër të kompanisë Carestream sipas kërkesës së AK dhe bashkë me këtë është paraqitur edhe autorizimi i kompanisë prodhuese Carestream. A ka paraqitur operatori ekonomik Almedical i kualifikuar nga KVO si një ofertues I cili plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga ky komision një autorizim të tillë nga prodhuesi???. Nëse po a mundet që në përgjigjen tuaj të na bashkëngjisni një kopje të këtij dokumenti. Bashkëngjitur këtij formulari ankese ju lutem gjeni edhe një shkresë nga kompania prodhuese Carestream (e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar) ku shprehet qartë se kompania Medfau shpk është e vetmja kompani e autorizuar nga kompania prodhuese carestream për tregëtimin e produkteve që kjo kompani prodhon. Kjo shkresë vë në dyshim vlerësimin që KVO ka bërë duke mos u bazuar tek kërkesat që vetë ky AK ka kërkuar. KVO duke pranuar një operator ekonomik pa autorizimin e prodhuesit në rradhë të parë ka shkelur një nga pikat e vlerësimit të ofertave duke bërë një njëanshmëri në vlerësim dhe në rradhë të dytë ka pranuar që të marrë produkte të pacertifikuara dhe të autorizuar nga prodhuesi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “kriteret e vecanta të kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

1. *Certifikate konformiteti CE sipas direktives 93/42/EEC ose 98/79/EEC per produktet e ofruara origjinale ose kopje e noterizuar ne vendin e origjines ose ekuivalent.*
2. *Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën 1 të DST)*
3. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi, për tregtimin e artikujve të ofruar. (të përkthyer dhe të noterizuar)*
4. *Katalogë për artikujt e ofruar, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishmepër artikullin e kërkuar. Kataloget do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Almedical” shpk në përmbushje të kriterëve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizim Prodhuesi datë 01.02.2019 lëshuar nga Ampronix drejtuar SU Shefqet Ndroqi me përmbajtje si vijon: Ampronix të cilët janë prodhuesit zyrtarë dhe shitësit e filmave radiografik me anë të kësaj autorizon: Almedical shpk të ofertojë, negocjojë

dhe përmbylli kontratën me ju ndaj ftesës për ofertë “Blerje materiale radiologjike për nevoja spitalore” për mallrat e ofruara nga ne. Me anë të kësaj ne zgjerojmë garancinë dhe sigurinë e plotë për mallrat e ofertuara për furnizim ndaj ftesës për ofertë nga firmat e mësipërme. Kjo letër është e vlefshme për një vit të plotë dhe mund të anulohet në cdo kohë.

- Deklarata konformiteti të prodhuesit Carestream
- Katalogë të prodhuesit Carestream

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

Public Health Sector

III.1.4. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht: *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

b) *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose*

c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP me shkresën nr.315/17 prot datë 05.03.2019 protokolluar me tonën me nr.293/2 prot datë 07.03.2019 me objekt “Dërgohet informacioni” rezulton se në procesverbalin nr.2 për hapjen dhe vlerësimin e ofertave datë 04.02.2019 sqarohet se kryetari i KVO i ka dërguar nëpërmjet SPE kërkesë për sqarim operatorit ekonomik “Almedical” shpk në lidhje me dokumentat kualifikuese të paraqitura në SPE me përmbajtje si vijon: *Bazuar në pikën 5 të kriterëve të vecanta “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për tregëtimin e artikujve të ofruar (përkthyer dhe noterizuar).Refereruar dokumentacionit të paraqitur në SPE , mostrës dhe katalogut të paraqitur pranë AK do të kërkonim nga ana juaj të na vini në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm për sa i përket Atorizimit të Prodhuesit. Mostra dhe katalogu janë të markës Carestream, mirpo ju keni sjellë vetëm Autorizimin e Apronix, ndërkohë që na duhet Autorizimi i Carestream tek Apronix , në mënyrë që të vërtetohet lidhja midis autorizuesit të prodhuesit Carestream me distributorin Apronix me ju si distributor Almedical.*

Në datën 08.02.2019 OE nëpërmjet SPE dërgoi sqarim mbi dokumentat e paraqitura si vijon: Almedical ka paraqitur në sistem dokumentacionin e kërkuar nga AK në pikën 5 të kriterëve të vecanta. Në DST nuk është cilësuar që të paraqitet një dokument lidhës midis distributorit dhe prodhuesit por vetëm autorizim distributori. Kërkesa në këto terma kohorë mbas përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave është e tepërt dhe e pabazuar ligjërisht në LPP. Vërtetimi i lidhjes së prodhuesit me distributorin mund të kërkojë kohë për posedimin e këtij dokumenti dhe ky është një pretendim i tepërt nga AK në rastin kur nuk është kërkuar në DST.

III.1.6. Referuar sa më sipër KPP konstaton se operatori ekonomik “Almedical” shpk në përmbushje të kriteve sa më sipër ka dorëzuar autorizim prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, lëshuar nga kompania Ampronix, ndërsa ka dorëzuar katalogët teknikë dhe deklaratat e konformitetit të prodhuesit Carestream.

KPP gjykon se dyshimi i krijuar edhe nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të cilët i janë drejtuar për sqarim operatorit Almedical shpk për lidhjen që ekziston mes dy kompanive Ampronix dhe Carestream rezulton i drejtë në rastin konkret cka provon edhe pretendimin e ankimesit se operatori ekonomik Almedical shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion të plotë për të provuar origjinën e mallit. Për më tepër që dokumenti i lëshuar nga Ampronix për shoqërinë Almedical shpk ka formatin e një autorizim prodhuesi dhe jo autorizim distributori pasi në përmbajtje të saj thuhet “Ampronix të cilët janë prodhuesit zyrtarë dhe shitësit e filmave radiografik” dhe në asnjë moment nuk citohet se distributorë të kujt janë Ampronix duke mos u provuar në asnjë rast lidhja që pretendon Almedical shpk se Ampronix janë distributorë të autorizuar të Carestream.

KPP gjykon se mungesa e një dokumenti provues që vërteton lidhjen mes dy kompanive krijon dyshime të bazuara pasi në rastin konkret deklaratat e konformitetit dhe katalogët

teknikë janë lëshuar nga një subjekt i ndryshëm nga ai i cili ka lëshuar dokumentin autorizim prodhuesi për distributorin Almedical shpk.

KPP gjykon se operatori ekonomik Almedical duhet në cdo rast të kishte paraqitur një dokument që provon lidhjen e prodhuesit me distributorin e autorizuar, nëse vërtet Ampronix është distributor i autorizuar i Carestream. Në këto rrethana KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Almedical” shpk nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin e mallrave.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Almedical” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, nuk mund të konsiderohet i plotë dhe i vlefshëm për sa kohë që nuk provohet me një dokument konkret lidhja mes dy kompanive “Carestream” në cilësinë e prodhuesit dhe Ampronix në cilësinë e distributorit të autorizuar prej tij.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Medfau” shpk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr.REF-05004-01-24-2019 me objekt “*Blerje Materiale Radiologjie për nevojat spitalore*” për vitin 2019 në SU “*Shefqet Ndroqi*” Tiranë - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 40,600 lekë pa tvsh, Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër: 4,872,000 lekë (pa TVSH). zhvilluar në datë 04.02.2019 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Al Medical” shpk duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Medfau” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 293 Protokolli; Datë 25.02.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha